

KREMTORE

E KISHES ORTHODOKSE



E Perktheu Imzót Fan S. Noli
E Botój Peshkopata e Amerikes

NENES SE DASHUR
MARIA STILIAN NOLI
PER KUJTIM TE PERJETME
PERKTHENJESI

BOSTON, MASS.

1947

PARATHENIE

Kjo liber, sipas titullit, permbán kendimet e te krémteve kryesore te palevizura te dymbedhjete múajve. Ne ketó shtuam te dy Kanunet e Shen Marise, Lutesoren dhe Dieloren, domethene Troparet e te Tete Tingejve me Apostujte dhe Ungjijte, qe kendohen ne te Díelat e zakonta te motit. Pothua te gjithë Troparet jane artuar pas ríthmeve dhe melodive Bizantine. Perkthimin e kemi bere lirisht, pas kuptimit edhe jo fjale pas fjale, nga Gerqishtja me perjashtimin e kendimeve te Shen Kozmájt te Beratit, te cilat i parafrazuam nga versioni Shqip i Krye-Hiresise Tij, Imzót Kristofór Kisi, Kryepeshkopit te Shqiperise. Nje pjese e madhe e ketyre Tropárove botohen ketú per heren e pare. Qe te gjitha kendimet, qe jane botuar mé pare, dalin taní ne drite te revizúara. Falenderojme te gjithë pajtimtarët, qe na perkrahne me ndihma te parepagúara, dhe veçanerisht Federaten "Vatra" me Deget e saj, te cilat mblotne mé teper se gjysmen e sumes totale te nevojshime per kujtimin e Faik Konitzes, Icrónjesit te gjuhës Shqipe dhe çampionit te independences kombetare.

Perkthénjesi

Boston, Mass., Prill 25, 1947.